



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik "Bosht Elevators" Sh.P.K. të datës 27.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Bosht Elevators" Sh.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Bosht Elevators" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Bosht Elevators" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi) me datë 27.02.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 23.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 026 211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka gjetur se me datë 19.02.2023 parashtruesit i ka skaduar vlefshmëria e ofertës. Paraprakisht, me datë 14.02.2023 autoriteti kontraktues përmes sistemit e-prokurimi ka dërguar te parashtruesi "Kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera" në përputhje me nenin 30 paragrafin 30.4. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"). Afati i fundit për dorëzimin e vazhdimin të vlefshmërisë së ofertës është përcaktuar pesë (5) ditë përkatësisht deri me datë 19.02.2023 kur edhe ka skaduar vlefshmëria e ofertës.

Në kuptim të nenit 30 paragrafit 30.6. të RRPP, së bashku me kërkesën e autoritetit kontraktues, parashtruesit i është tërhequr vëmendja si në vijim "Ju informojmë se është e drejta juaj që të vendosni nëse dëshironi të zgjatni validitetin apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohen si të papërgjegjshëm".

Parashtruesi asnjëherë nuk ka njoftuar autoritetin kontraktues për zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës siç është kërkuar nga ai me datë 14.02.2023 përmes sistemit e-prokurimi. Në këtë mënyrë është konstatuar se parashtruesi nuk ka zgjatur vlefshmërinë e ofertës së vet.

Përmes nenit 30 paragrafit 30.6. RRPP përcaktohet se "Është e hapur për secilin OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre **do të refuzohet si "të papërgjegjshëm"** dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre".

Tutje përmes nenit 47 paragrafit 45.22. të RRPP përcaktohet se "Një tender konsiderohet të jetë formalisht **i përgjegjshëm** nëse i plotëson të gjitha kërkesat formale në Dosjen e tenderit, duke mos u larguar në mënyrë të konsiderueshme nga to ose duke vënë kufizime mbi to. Këto kërkesa formale mund të jenë në lidhje me plotësimin e formularit të tenderit, sigurim i tenderit etj".

Bazuar në dispozitat e cituara më sipër të RRPP dhe duke marrë në konsideratë faktin se parashtruesi nuk ka zgjatur vlefshmërinë e ofertës siç është kërkuar nga ai me datë 14.02.2023 nga autoriteti kontraktues, është gjetur se parashtruesi në këtë aktivitet të prokurimit duhet të konsiderohet si operator ekonomik i papërgjegjshëm. Në këtë mënyrë parashtruesi nuk ka dëshmuar interes material në raport me aktivitetin përkatës të prokurimit.

Përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP") përcaktohet përkufizimi i termit "Palë e interesuar" si në vijim: "*personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*".

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk është palë e interesuar për aktivitetin e prokurimit lidhur me të cilin ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim. Rrjedhimisht kërkesa e tij për rishqyrtim e datës 27.02.2023 është refuzuar si e pabazuar në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nënparagrafit d).

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.03.2023


Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.